



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:089739
Datë: 08.07.2024
Numri i dokumentit: 05911457

AA.nr.315/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, në konfliktit administrativ, sipas padisë së paditëses Komuna e Prizrenit, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster, përfaqësuar me autorizim R.A, kundër të paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës te cilin me autorizim e përfaqëson N,Sh, me palë të interesit Ë.P të cilin e përfaqëson me autorizim Ruzhdi Berisha avokat në Prizren, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e palës se interesit Ë.P të cilin e përfaqëson me autorizim Ruzhdi Berisha avokat në Prizren, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative, A.nr.1254/2020, të datës 30.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 08.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e palës se interesit Ë.P të cilin e përfaqëson me autorizim Ruzhdi Berisha avokat në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1254/2020, i datës 30.03.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1254/2020, të datës 30.03.2023, në pikën I të dispozitivit është ndërprere procedura në këtë çështje të konfliktit administrativ sipas padisë të paditësit Komuna e Prizrenit të datës 22.07.2020 lënda A.nr.1254/20, deri në nxjerrjen e vendimit gjyqësor sipas lëndës C-III-20-0076, si çështje paraprake. Ndërsa në pikën II. të dispozitivit është vendosur qe gjykimi i ndërprerë do të vazhdoj me propozimin e palës pasi të kenë pushuar shkaqet e ndërprerjes si në pikën I të dispozitivit.

Kundër aktvendimit të lartcekur, ka ushtruar ankesë përfaqësuesi me autorizim i palës së interesit Đ.P avokat Ruzhdi Berisha nga Prizreni për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave të Procedurës Kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Me propozim që aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që të refuzohet si i pabazuar propozimi i paditëses komuna e Prizrenit për ndërprerjen e procedurës në këtë çështje juridike dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në procedurë të mëtejshme ose të prishet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, pretendimet ankimore të palës së interesit, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Konfliktin Administrativ (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, Komuna e Prizrenit me padinë e datës 22.07.2020, kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës, ka kërkuar që të aprovohet në tersi kërkesëpadia si e bazuar dhe të anulohet vendimi i datës 17.07.2020.

Paditësja komuna e Prizrenit me parashtrësën e datës 09.02.2023 i ka propozuar/kërkuar gjykatës ndërprerjen e procedurës në konfliktin administrativ me arsyetimin se, për të njëjtën çështje është duke u zhvilluar procedura gjyqësore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër të lëndës C-III- 20-0076 lidhur me vërtetimin e pronësisë dhe caktimin e masës së sigurimit për pronën kontestuese ngastrën nr. 7141-1 ZK Prizren ku gjykatës i është dorëzuar edhe një kopje të aktvendimit masës së sigurisë C III-20-0076 të datës 05.10.2020 lidhur me padinë e paditësit NTSH Liria përfaqësuar nga Agjencia e Kosovare e Privatizimit, kundër të paditurës, komuna e Prizrenit dhe Đ.P. Nga kjo për shkak ekonomizimit të procedurës dhe çështjes parapake i propozon gjykatës që jashtë seancës të vendos për ndërprerjen e kësaj procedure deri në zgjidhjen e çështjes paraparak nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës. Me tej thekson se pala e interesit Đ.P është informuar me vendimin e lartcekur nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë pasi që mori dhe vlerësoi të dhënat e cekura si më lartë, nga shkresat e lëndës ka konstatuar se pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për të njëjtën çështje është duke u zhvilluar procedura me numër të lëndës C-III- 20-0076 për shkak të vërtetimit të pronësisë - caktimin e masës së sigurimit për pronën kontestuese ngastrën nr. 7141-1 ZK Prizren, lidhur me padinë e paditësit NTSH Liria përfaqësuar nga Agjencia e Kosovare e Privatizimit kundër, të paditurës komuna e Prizrenit dhe Đ.P. Andaj, duke pasur parasysh se është duke u zhvilluar procesi gjyqësor lidhur me vërtetimin e pronësisë së lartcekur në Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe duke pasur parasysh se në procedurën e konfliktit administrativ nga paditësja komuna e Prizrenit kërkohet e njëjta patundshmëri të regjistrohet në regjistrat kadastral nga e paditura- Agjencia Kadastrale e Kosovës. Gjykata e shkallës së parë me qëllim të vendosjes së çështjes në merita dhe duke pasur parasysh se është konstatuar një çështje parapake ka ndërprerë procedurën deri në nxjerrjen e vendimit në kuptim të nenit 32 të LKA-së ku përcaktohet se:” Kur vendimi i gjykatës në konfliktin administrativ varet nga çështja juridike e cila përbënë tërësi të mëvetësishme juridike, e mbi të cilën gjykata tjetër ose organi tjetër nuk ka vendosur (çështja parapake), gjykata që zhvillon konfliktin administrativ, mund ta vendos atë çështje, nëse me ligj nuk është përcaktuar

ndryshe; ose mund ta ndërpresë procedurën deri në nxjerrjen e vendimit mbi çështjen paraprake, nga ana e organit kompetent. Vendimi i gjykatës mbi çështjen paraprake ka efekt juridik vetëm në konfliktin administrativ, në të cilin ajo çështje është zgjidhur”.

Gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 63 të LKA-së mori parasysh edhe nenin 277 Ndërprerja e gjykimit dhe pushimi i gjykimit, pika (a) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore ku përcaktohet: “Procesi gjyqësor ndërpritet: f)kur ndërprerja e gjykimit parashihet me ndonjë ligj”. Për të vendosur si në pikën dy të dispozitivit Gjykata kishte parasysh nenin 280.4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ku përcaktohet: ”Në të gjitha rastet e tjera gjykimi i ndërprere do të vazhdoj me propozimin e palës pasi të kenë pushuar shkaqet e ndërprerjes”. Andaj, duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim të nenit 32 të Ligjit për Konfliktet Administrative lidhur me nenin 277 të LPK-së.

Me dispozitën e nenit 278 par.1 pika a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se “Përveç rasteve të parashikuara me këtë ligj, gjykata ndërpret gjykimin: a) po që se ka vendosur që vetë të mos e zgjidh çështjen paraprake .” Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore të lartcekur, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me të drejtë ka ndërprere procedurën sipas padisë së paditëses në këtë çështje juridiko – administrative.

Kolegji vlerëson të drejtë këtë qëndrim juridik të dhënë në aktvendimin e ankimuar, pasi që është konstatuar se pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për te njëjtën çështje është duke u zhvilluar procedura me numër te lendes C-III- 20-0076 për shkak të vërtetimit të pronësisë - caktimin e masës se sigurimit për pronën kontestuese ngastrën nr. 7141-1 ZK Prizren, lidhur me padinë e paditësit NTSH Liria përfaqësuar nga Agjencia e Kosovare e Privatizimit kundër, të paditurës komuna e Prizrenit dhe Đ.P. Andaj, duke pasur parasysh se është duke u zhvilluar procesi gjyqësor lidhur me vërtetimin e pronësisë së lartcekur në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe duke pasur parasysh se në procedurën e konfliktit administrativ nga paditësja komuna e Prizrenit kërkohet e njëjta patundshmëri te regjistrohet në regjistrat kadastral nga e paditura- Agjencia Kadastrale e Kosovës. Gjykata e shkallës së parë me qëllim të vendosjes së çështjes dhe duke pasur parasysh se është konstatuar një çështje paraprake me të drejtë e ka ndërprerë procedurën deri në nxjerrjen e vendimit në kuptim të nenit 32 të LKA-së. Andaj aktvendimi nga gjykata e shkallës së parë është marr duke respektuar dispozitat ligjore dhe procedurale, konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe me zbatim të drejtë të së drejtës materiale.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, thëniet e ankesës se është bërë shkelje procedurale nga neni 182 par.1 lidhur me nenin 13 par.1 dhe 278 par. 1 pika a) si dhe nga neni 182 par.2 pika n) të LPK-së. Pastaj se gabimisht është konstatuar në aktvendim se kinse edhe pala me interes në këtë procedurë Đ.P është palë e paditur në procesin gjyqësor pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Kjo nënkupton se përkitazi me faktet vendimtare ekziston kundërthënia ndërmjet asaj që është thënë në arsyet e aktvendimit lidhur me faktin se kush janë palë në procedurë dhe se vendosja në atë procedurë nuk përfaqëson çështjet paraprake në këtë procedurë të konfliktit administrativ. Këto pretendime ankimore ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se këto pretendimet ankimore janë pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e ndërprerjes së procedurës sipas padisë së paditëses, e pasi që me pretendimet ankimore të palës së interesit se vendosja sipas kërkesës së paraqitur pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës sipas lëndës C-III-20-0076 në asnjë mënyrë nuk përfaqëson çështje paraprake për vendosje në këtë konflikt administrativ, një aktvendim i tillë nuk mundë të vihet në pyetje, andaj ankesa e palës së interesuar u refuzua si e pa bazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 209 pika b) të LPK-së dhe nenit 63 të LKA-së për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AA.nr.315/2023, me datë 08.07.2024

Kryetari i kolegjit
Ramiz Kuqi